




**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Autoriteti i Konkurrencës**  
**Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority**



**Nr. 32/2023**

**Prishtinë, më 17.03.2023**

Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës bazuar në neni 26, neni 27, neni 35, neni 55 paragrafi 2 nën paragrafi 2.6 i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 08/L-056, Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, bazuar në kërkesën me nr. Prot. 257/22- 01/H nga Z. Milot Deliu agjent i ndërmarrjes Kompania e Sigurimeve Eurosig Sh.a. kundër ndërmarrjes NTP “Auto –Atlas” në Shtime, lidhur me pretendimin për Keqpërdorim të Pozitës Dominuese, në mbledhjen e mbajtur me datën 17.03.2023, merr këtë:

### **K O N K L U Z I O N**

Me të cilën konkludon se Autoriteti i Konkurrencës, nuk është kompetent për të shqyrtuar ankesën e z. Milot Deliu, sipas ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, bazuar në nenin 55 paragrafi 2 nën paragrafi 2.6 i Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës.

### **A r s y e t i m**

Me datë 23.09.2022 shkresa me nr. Prot. 257/22- 01/H nga Z. Milot Deliu agjent i ndërmarrjes kompania e sigurimeve Eurosig Sh.a. i cili operon në komunën e Shtimes, kundër ndërmarrjes NTP „Auto-Atlas”, lidhur me pretendimin për Keqpërdorim të Pozitës Dominuese.

#### **Pretendimet e paraqitësit të iniciativës:**

Meqenëse Autoriteti i Konkurrencës është institucion publik, i pavarur në kryerjen e detyrave të veta të përcaktuara në këtë ligj, dhe politika e konkurrencës është një element i domosdoshëm i një tregu të lirë, që funksionon duke siguruar që të gjitha ndërmarrjet konkurrojnë në mënyrë të barabartë dhe të drejtë në bazë të meritave të tyre.

Kjo reflektohet edhe me qëllimin e përcaktuar në ligjin për mbrojtjen e konkurrencës, duke u mbështetur në tri shtylla kryesore që përcaktojnë mbrojtjen e konkurrencës:

Abuzimin me pozitën dominuese

Marrëveshjet e ndaluara në formën e karteleve dhe

Bashkimet ose përqendrimit e ndërmarrjeve.

Mirëpo fatkeqësisht një konkurrencë e drejt nuk është zhvilluar viteve te fundit në komunën e Shtimes për shkak të pozitës dominuese te operatorit ekonomik, Kontrollimit Teknik te Automjeteve ATLLAS.

Si pasojë e Ligjit nr. 05/L-132 për Automjete, përkatësisht Neni 87 paragrafi 2 dhe neni 89 paragrafi 2 dhe 3 me të cilin kufizohet ofrimi i shërbimeve ndaj konsumatorit brenda komunës ku ka vendbanimin pronari i mjetit. Me këtë rast iu imponohet zgjedhja e shërbimeve apo produktit dhe i drejton ata tek operatorë të caktuar komunal me rastin e ofrimit të shërbimeve për kontrollimin teknik

të automjeteve, dhe kushtëzim në marrjen e produktit TPL të Auto përgjegjësisë në kompanitë e sigurimeve të caktuara.

Sepse konsiderojmë që kundërligjshëm më datën 22.09.2022 jemi detyruar të anulojmë policën e sigurimit me numër 9619556 (EUROSIG) në emër të pronarit Muhamet Mulaj, pasi i njëjti pronar veturën e tij të tipit Daimler Chrysler me numër shasisë: WDB1680081J520235 e dërgojmë në Kontrollim Teknik tek qendra e kontrollës teknike ATLLAS, pas kontrollimit konstatohet mos kalueshmëria dhe jepet certifikata e refuzimit me vulë të kuqe. E njëjta veturë dërgohet prapë pas presionit për anulimin e sigurimit dhe pasi detyrohemi në ora 15:08 me anulë policën e sigurimit. Të njëjtën veturë me presion ndaj pronarit (posedojmë fakte) pa ndonjë rregullim të defektit (defekt të pretenduar) e detyrojnë të shtypë policën e sigurimit në emër te agjentit Haki Ademaj (kompania SIGAL. E gjitha procedura e anulimit dhe shtypjes së policës ndodhë në intervalin kohor brenda 30 min, argument që vërteton mos intervenim në mënjanim të "defektit të pretenduar" mund të vërtetohet në sistem data e shtypjes së kësaj police me numër 9620428) njëherit edhe inspektues ne po të njëjtën qendër të kontrollimit teknik.

#### **Tregu relevant**

**Tregu gjeografik** - duke iu referuar nenit 6 të Udhëzimit Administrativ për mënyrën dhe kriteret e përcaktimit të tregut përkatës Nr. 02/2018, bazuar në analizën e këtij rasti, tregu gjeografik do të konsiderohet territori i Komunës së Shtimes.

**Tregu i produktit** - Kontrollimi Teknik i Automjeteve në Shtime.

#### **Përshkrimi i Gjendjes Faktike**

Sipas Ligjit Nr.05/L-132 për Automjete neni 87, Organizimi i kontrollimit teknik të mjeteve, Paragrafin Nr.1 është paraparë: procedurat e kontrollimit teknik të mjeteve janë unike për të gjitha subjektet të cilat e ofrojnë shërbimin e kontrollit teknik të mjeteve, gjithashtu Paragrafi Nr. 2 Ministria përcakton çmimoren për kontrollim teknik. Çmimi është unik dhe vlen për të gjitha subjektet e autorizuar për kontrollim teknik.

Neni 78, Zbatimi i kontrollimit teknik, paragrafi Nr.1, Kontrollimi teknik i mjeteve duhet të bëhet në harmoni me rregulloret valide dhe duke përdorur pajisje matëse pa të meta teknike të përshkruara dhe pajisjet tjera, pajisjet matëse duhet të jenë të miratuara të kontrolluara dhe të certifikuara në përputhshmëri me rregullat e meteorologjisë dhe të kalibruara siç duhet, nëse për to nuk ekzistojnë rregulla të meteorologjisë, atëherë gjatë realizimit të kontrollimit teknik merren në konsideratë edhe udhëzimet për përdorimin e pajisjeve të cilat përdoren për kontrollimin teknik.

Paragrafi Nr. 2, Kalibrimi i pajisjeve të kontrollit teknik të mjeteve bëhet pas kontrollit të shtatë mijë (7000) mjeteve. Çmimi për kalibrim përcaktohet me akt nënligjor nga Ministria përkatëse për Tregti dhe Industri, në bashkëpunim me Ministrinë. Paragrafi Nr.3 Në qoftë se gjatë kontrollimit teknik konstatohet se mjete është pa të meta teknike atëherë i lëshohet certifikata në të cilën shënohet afati me të cilin mjete duhet të bëjë kontrollimin teknik të ardhshëm. Paragrafi 4. Dënohet me gjobë nga tetëmijë (8000) € deri në 15.000.00 € subjekti juridik për kontroll teknike i cili gjatë kontrollimit teknik vepron në kundërshtim me këtë nen, ose e lëshon certifikatën e kontrollimit teknik pa qenë prezent mjete, ndërsa personi përgjegjës dënohet me gjobë në vlerë prej katërqind (400) €.

Gjithashtu Neni 89, Licencimi i subjekteve juridike për kontrollim teknik, Paragrafi Nr. 2 potencohet se: Nuk mund të licencohet asnjë subjekt i ri apo linjë e re për kontroll teknik nëse mesatarja e numrit të kontrolleve teknike të të gjitha subjekteve për kontroll teknik brenda territorit të një komune nuk ka



kaluar katër mijë (4000) kontrole brenda vitit. Gjithashtu paragrafi 3. Kontrolli teknik i mjeteve mund të bëhet vetëm brenda Komunës ku e ka vendbanimin pronari i mjetit. Nëse brenda Komunës nuk ka subjekte për kontroll teknik, atëherë kontrolli bëhet brenda rajonit ku e ka vendbanimin pronari i mjetit.

### **Analiza e Konkurrencës**

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës, ka mandat identifikimin e marrëveshjeve të ndaluara (kartelet), përcaktimin e pozitës dominuese dhe keqpërdorimin e sajë, me të cilat përcaktohen masat, kushtet dhe afatet për eliminimin e efekteve të dëmshme, dhe ndalimin e çdo sjelljeje të mëtejshme që çon në marrëveshje të ndaluar, keqpërdorim i pozitës dominuese, si dhe vlerësimi ex ante i ndërmarrjeve në proces të përqendrimeve, në bazë të analizave të hollësishme ligjore dhe ekonomike sipas procedurave ligjore. Autoriteti kryen detyrat si një organi i pavarur për mbrojtjen e konkurrencës, në të gjitha tregjet ekskluzivisht brenda fushëveprimit dhe kompetencave të përcaktuara nga Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Autoriteti në rastin konkret, nuk është kompetent për zbatimin e ligjit të veçanta, por aspekti ligjor dhe rregullativ është në kompetencë të rregullatorëve të tjerë sektorialë, e në këtë rast Ministria e Infrastrukturës, e cila përmes Ligjit Nr.05/L-132 për Automjete, e ushtron të drejtën si autoritet publik, përgjegjëse për kontrollimin teknik të automjeteve, mbikëqyrjen dhe zbatimin e tyre si dhe vendosjen e gjobave subjektit juridike dhe personave përgjegjës për kontrollim teknik, me të cilin gjatë kontrollimit teknik vepron në kundërshtim me ligjin ose e lëshon certifikatën e kontrollimit teknik pa qenë prezent mjeti. Për nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Konkluzioni.

Ky konkluzion, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Komisionit.

### **Autoriteti i Konkurrencës**

**Komisioni**

**Neime Binaku - Isufi**

**Kryetare**



  
**Kaltrina Sela**  
Nënkryetare

  
**Nafije Osdautaj**  
Anëtare

**Këshilla juridike:** Kundër këtij konkluzioni nuk është e lejuar ankesa, por pala me padi mund të iniciojë konflikt administrativ pranë Gjykatës kompetente për çështje administrative.

Me këtë KONKLUZION të njoftohen:

- Paraqitësi i iniciativës
- Arkiva
- Publikohet në web faqen e AKRK-së